



Konferenca rajonale " Emigrimi në rrugën ballkanike- koordinimi i donatorëve dhe sfidat humanitare", Shkup 2015



Në organizim të Sekretariatit për çështje evropiane, në bashkëpunim me Këshillin për bashkëpunim Rajonal - RCC, u mbajt konferenca rajonale me temë " Emigrimi në rrugën ballkanike- koordinimi i donatorëve dhe sfidat humanitare".

Fjalime hyrëse në Konferencë patën Zëvendëskryeministri z. Fatmir Besimi, Shefi i delegacionit të Bashkimit Evropian në Shkup, shkëlqesia e tij, Aivo Orav, Ministri i punëve të brendshme, z. Oliver Spasovski dhe Koordinatori i Përhershëm i Kombeve të Bashkuara, z. Luiza Vinton.

Konferenca kishte për qëllim ti shoqëroj palët e interesuara në drejtim të përforcimit rrjetit, përmirësimi i kanaleve të komunikimit për çështjet e migracionit, shkëmbimin e përvojave dhe praktika më të mira mes të gjitha subjekteve relevante në nivelin nacional, regjional dhe ndërkombëtar, me qëllim për të kontribuar në menaxhimin (trajtimin) e sfidës me emigrantët/refugjatët. Në konferencë morën pjesë përfaqësues dhe ekipe të ekspertëve nga vendet e rajonit, Komisioni Evropian, ambasadorët e BE-

së në vend, organizatat ndërkombëtare të cilat veprojnë në nivel rajonal dhe përfaqësues të organeve shtetërore të cilat punojnë në domenin e emigrimit. Diskutimet në fokusin tyre e kishin sfidën e emigrantëve nga aspekti i bashkëpunimit rajonal të donatorëve, si dhe menaxhimit me sfidën humanitare.

Agjendë



Rëndësit përfundimtare

Para kalimit, vendet anëtare në konferencën e sotshme me titull " " Emigrimi në rrugën ballkanike- koordinimi i donatorëve dhe sfidat humanitare" e konfirmuan rëndësinë dhe kuptimin e rezolutave të cilat kanë të bëjnë me emigracionin, dhe të cilat ishin të miratuara nga të gjitha shtetet anëtare dhe të nënshkruara nga të gjitha vendet pjesëmarrëse.

- Rezoluta e Parlamentit Evropian prej 29 Prill 2015 për tragjeditë e fundit në Detin Mesdhe dhe politikën e BE-së për migracionin dhe azilin (2015/2660 (RSP));
- Rezoluta e Parlamentin Evropian prej 10 Shtator 2015 për migrantët dhe refugjatët në Evropë(2015/2833(RSP))
- Rezoluta nr 1210 e Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (e merituar në 24 Nëntor të vitit 2015 nga ana e Këshillit në seancën E 106-të) në kuadër të Kornizës përmesaxhimine migracionit.
- Rezoluta me nr 1243 e Organizatës Nderkombëtre për maigracion (E miratuar më 27 Nëntor të vitit 2012 nga ana e Këshillit në seancën 523 të) në kuadër të kornizës operacionale të Organizatës Ndërkombëtare për krizën e migracionit.

Si dhe rëndësia e:

- Planit akcionar me 17 pika prej 25 tetoritviti 2015
- Raportet për progresin e Greqisë, Italisë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor prej 15 dhjetorit viti 2015
- Takimet dhe konsultimet e vazhdueshme në nivel të lartëmidis vendeve të kyçura

Duke i patur parasysh, duke i respektuar dhe duke iu përmbajtur pikave të mëparshme, pjesëmarrësit e kësaj konference i miratuan këto:

KONKLUZA

1. Vendet e rajonit theksuan përshtypjen se situata e migracionit, e cila manifestohet gjatë rrugës të Ballkanit Perëndimor, paraqet një sërë sfidash që kanë prekur të gjitha vendet dhe organizatat e përfshira. Rrjedhimisht, në këtë kontekst, u dakorduan se secila palë duhet të zhvillojë mekanizmat e duhura mbështetëse, dhe të intensifikojë bashkëpunimin me palët e tjera të përfshira në mënyrë që të zgjidhë problemet e paraqitura.

2. Vendet në rajon kanë konfirmuar se ndihma humanitare mbetet një prioritet si për afat-shkurtër ashtu dhe për afat-gjatë, veçanërisht në valën e ardhshme dhe të parashikuar të migrantëve. Nëkuadër të këtij aspekti, është e nevojshme, e vlerësuar dhe e mirëpritur bashkëpunimi i mëtutjeshëm dhe përfshirja e Bashkimit Evropian dhe të organizatave partnere ndërkombëtare për shtetet e Ballkanit Perëndimor të ju mundësohet angazhimi i plotë për të vazhduar harmonizimin e mëtutjeshëm të aktiviteteve humanitare. Një shqetësim kryesor është dhe do të mbetet, siguria e përgjithshme dhe siguria për të gjithë qytetarët dhe migrantët.

3. Vendet e rajonit e kanë mirëpritur rritjen e angazhimit të FRONTEX dhe organizatave partnere ndërkombëtare duke theksuar se, duhen të merren parasysh aktivitete shtesë. Në këtë drejtim, aktivitetet kanë të bëjnë me forcimin e kapaciteteve për pritjen e emigrantëve; identifikimi, përpunimi dhe përzgjedhja e atyre që vijnë në kufijtë, si dhe aktivitetet dhe masat për luftën e suksesshme kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe formave të tjera të krimit ndërkufitar, që ndikojnë në sigurinë e përgjithshme. Të drejtat e njeriut do të mbrohen dhe respektohen plotësisht.

4. Vendet e rajonit do të vazhdojnë përpjekjet e njëpasnjëshme dhe të vazhdueshme për koordinimin e aktiviteteve që lidhen me çështjen e migrantëve, rrjedhimisht duke vazhduar me reformat që lidhen me integrimin evropian dhe antarësimin në Bashkimin Evropian. Vendet në rajon gjithashtu i bëjnë thirrje Bashkimit Evropian dhe organizatave partnere ndërkombëtare për të intensifikuar më tej përpjekjet nga ana e tyre për të krijuar mjete dhe zgjidhje më të mira në përgjithësi për të gjithë kontinentin.

